



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 1084/5 Prot.

Tiranë, më 04.04.2018

V E N D I M

Nr. 21, Datë 04.04.2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 6 SUBJEKTE TË ALUIZNI-T “MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË MASAVE TË REKOMANDUARA NË AUDITIMET E MËPARSHME”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara gjatë vitit 2015 dhe 2017, sipas programeve të auditimit me nr. 1084/1, datë 23.10.2017 dhe nr. 1095/1, datë 23.10.2017 miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Shtetit si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në 6 subjekte të audituar (DP e ALUIZNI-t Tiranë, DR ALUIZNI Lezhë, Gjirokastër, Tirana 2, DR ALUIZNI Korçë dhe AT Pronave Tiranë) ka rezultuar si më poshtë:

- Janë rekomanduar gjithsej **186** masa, nga të cilat janë pranuar **158** masa, ose 85 % e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **28** masa, ose 15 %.

a- Niveli i realizimit të masave, sipas llojit paraqitet si më poshtë:

a.1. Masa organizative, nga **152** të rekomanduara, janë pranuar **137**, pra 90.13 %, janë zbatuar plotësisht **127** masa, ose 83.5 %, pjesërisht **5 masa** ose 3.3 %, në proces zbatimi **7 masa**, ose 3.9 % dhe **13** masa të pranuar dhe të pazbatuara, ose 8.5 %.

a.2. Masa shpërblim dëmi, nga **34** masa të rekomanduara, janë pranuar **17**, ose 50 %, janë zbatuar plotësisht 4 masa, ose 11.8 %, pjesërisht 12 masa ose 35.3 %, në proces zbatimi 1 masa, ose 2.9 % dhe 17 masa të papranuara dhe që nuk ka filluar zbatimi, ose 50 %.

Zbatimi për masa zhdëmtimi është si vijon: **34** masa të rekomanduara me vlerë **144,430 mijë lekë**, janë pranuar **17** në vlerë **10,545 mijë lekë** ose 6,5 %, janë zbatuar plotësisht **7** masa me vlerën **1,788 mijë lekë** ose 1.2 %, janë zbatuar pjesërisht **10** masa me vlerën **8,757 mijë lekë**, ose 6 %, dhe janë pazbatuar (pa arkëtuar) **17** masa me vlerë **123,340 mijë lekë, ose 86.3%**.

b.3. Masa disiplinore, nga **64** masa të rekomanduara, janë pranuar 36 masa, ose 56 %, nga të cilat janë zbatuar 36 masa ose 56 %. Për 28 masa nuk ka informacion nga institucionet e prore (D.P. ALUIZNI Tiranë).

Bazuar në korrespondencën me subjektet brenda afatit 20 ditor, lidhur me planin e masave për rekomandimet e lëna gjatë auditimit, rezulton se nga masat organizative dhe për shpërblim dëmi të rekomanduara, nuk janë pranuar 28 rekomandime ose 15 % (15 masa organizative dhe 13 masa shpërblim dëmi), ku përmendim subjektet:

- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, nuk ka pranuar 3 rekomandime (masa shpërblim dëmi).
- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Gjirokastrë, nuk ka pranuar 1 rekomandim (masë shpërblim dëmi).
- Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2, nuk ka pranuar 3 rekomandime (masa shpërblim dëmi).
- Drejtoria Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë, nuk ka pranuar 3 rekomandime (masa shpërblim dëmi)
- ATP nuk ka pranuar 6 rekomandime (masa shpërblim dëmi dhe mospërdorimin me efektivitet të fondeve të buxhetit)

Në zbatim të kërkesave të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjektet kanë kthyer përgjigje brenda 20 ditëve në KLSH, mbi masat e mara për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportet përfundimtare të auditimit nga KLSH, sipas afateve të përcaktuara. Konstatohet se 1 subjekt D.R. ALUIZNI Qarku Gjirokastrë nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikë 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm”, të ushtruar në 6 subjektet të audituara në periudhën 25.10.2017 deri në 20.12.2017.

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për të gjithë subjektet e audituara, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

A.1 Për Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë:

- Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të rikërkojë nga Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës, që të përgatisë dhe propozojë pranë Këshillit të Ministrave ndryshimet e nenit 46 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, duke përfshirë nenin 27, në të drejtat që i jepen Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kjo është kërkuar në rekomandimin e mëparshëm në zbatim të Vendimit nr. 42, datë 30.04.2017 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjithashtu, Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës ti propozojë Këshillit të Ministrave, të ndryshojë pikën 5, të VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, sipas së cilës “.....Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara,

pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”, e cila është në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9482, datë 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar.

Argumentimi

Ka mospërputhje mes zbatimit të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”.

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të legalizimit të objekteve/shtesave anësore dhe në lartësi pa leje, ka rezultuar se Drejtoritë e ALUIZNI-t, pasi kanë lëshuar lejet e legalizimit, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, kanë dërguar pranë Njërive të Qeverisjes Vendore vetëm shkresën me të dhënat për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë më parë konfirmimin e kryerjes së kësaj pagese, duke ju referuar VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ku citohet se: *Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nenin 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”, Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin: pika “ç” –“**vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi**”*

Për sa më sipër propozohet:

I- Neni 46, pika 1 e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar,

Ishte:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me nenet 2, 4, 15, 17 pika 2, 18, 28, 34 e 45 të këtij ligji”

Bëhet:

“Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në përputhje me nenet 2, 4, 15, 17 pika 2, 18, **27**, 28, 34 e 45 të këtij ligji”

II- Pika 5 e VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”,

Ishte: *“Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.*

Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”

Bëhet:

Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në

përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Drejtoritë e ALUIZNI-t:

a- Për zbatimin e kësaj pike, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore të dhënat e ndërtimeve që do të pajisen me leje legalizimi.

b- Në momentin e lëshimit të lejes së legalizimit të administrohet në dosjen e objektit informal vërtetimi mbi pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

Konkretisht nga auditimet e ushtruara në:

-Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana nr. 2, në **1660 raste** në kualifikimin e objekteve informale, ALUIZNI ka dërguar pranë Bashkisë Tiranë vetëm shkresën për llogaritjen e pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 32,385,690 lekë.**

-Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Korçë, në **375 rastet** në kualifikimin e objekteve informale, ALUIZNI janë dërguar pranë Bashkive rang Qarku vetëm shkresën për llogaritjen e pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi duke krijuar një **mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 38,506,651 lekë.**

I. NË DREJTORINË PËRGJITHSHME TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE

Nga auditimi u konstatua se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 512/10, datë 27.09.2017, ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, Raportin Përfundimtar të Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. Me shkresën nr. 3099/6, datë 23.10.2017, Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë, ka kthyer përgjigje brenda afatit **20 ditor**, për zbatimin e detyrave të rekomanduara.

Nga Drejtoria e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, në zbatim të rekomandimeve sipas shkresës nr.512/10, datë 27.09.2017 të KLSH "Raporti Përfundimtar i Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse." në zbatim me ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenit 30, pika 2, është dërguar informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, me shkresën **nr.3099/6, datë 23.10.2017**, "Informacion mbi Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet të auditimit të KLSH-së" ka informuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, së bashku me masat disiplinore të mara.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, është trajtuar në vijim:

Nga ana e KLSH me shkresë përcjellëse janë lënë **13** Rekomandime gjithsej, nga këto:

10 masa organizative, **3** masa zhdëmtimi me vlerën **556,217** lekë dhe **4** masa disiplinore, "vërejtje me shkrim" dhe 1 masë "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", deri në "largim nga puna".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 10 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 8 dhe pjesërisht 1 rekomandim dhe pa zbatuar 1 rekomandim.

-Për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime për me vlerë 556,217 lekë, nuk janë pranuar nga Drejtoria e përgjithshme e ALUIZNI-t

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, Tiranë përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 512/10, datë 27.09.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

I.A MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1

Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, të marrë masat që për sa kohë konstatohet nevoja për staf të eliminoje risqet e larta operacionale që ka stafi i marrë me kontratë duke studiuar me kujdes nevojat për staf e fond dhe të kërkojë ndryshimin e strukturës me Vendimin e Këshillit të Ministrave të miratuar nga Kryeministri.

Menjëherë

I.B MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.1

Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 31.12.2015-11.05.2016 në vlerën **100,444 lekë** nga operatori ekonomik “S” SHPK., si përfitim i padrejtë.

Rekomandimi 1.2

Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 11.05.2016-07.04.2017 në vlerën **251,841 lekë** nga operatori ekonomik “T” SHPK., si përfitim i padrejtë.

Rekomandimi 1.3

Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 07.04.2017–01.01.2018 në vlerën **203,931 lekë** nga operatori ekonomik “T” SHPK., si përfitim i padrejtë.

Menjëherë

II. NË DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE QARKU LEZHË

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë, ka rezultuar:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 990/8, datë 01.03.2017, ka dërguar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë dhe me nr. 990/9, datë 01.03.2017 në Drejtorinë Përgjithshme ALUIZNI-t Tiranë, Raportin Përfundimtar të Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Me urdhrin nr. prot. 1155, datë 24.03.2017 nga Drejtori Rajonal i ALUIZNI-t Qarku Lezhë është ngritur Grupi i Punës për zbatimin e detyrave të rekomanduara. *Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

- Me Urdhër nr. prot. 1486/2, datë 31.03.2017 lënda: “Mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit në Drejtorinë e ALUIZNI-t Lezhë” nga Drejtori Përgjithshëm i ALUIZNI-t, është shprehur opiniononi mbi rekomandimet dhe çështjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të auditimit.

-Në shkresën nr. 1486/2, datë 31.03.2017 Drejtori i Përgjithshëm mbështetur mbi Propozimet e KLSH për masa disiplinore ka njoftuar marrjen e masave disiplinore nga propozimi për “Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)” për 4 punonjës është marrë masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga puna, ndërsa nga propozimi për 11 punonjës i masës “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)” është marrë masa “vërejtje me shkrim”

Nga Drejtoria Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë, në zbatim të rekomandimeve sipas shkresës nr. 990/8, datë 01.03.2017 të KLSH “Raporti Përfundimtar i auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse.”, në zbatim me ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 30, pika 2, është dërguar informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1744, datë 28.04.2017.

Realizimi i programit (Plan-veprimit) dhe raportimi në KLSH, për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-muaj nga data e njoftimit të “Kërkesës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e fundit”, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

3. Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Drejtorinë e Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë.

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me “Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2014-30.09.2016. në Drejtorinë e Rajonale të ALUIZNI-t Qarku Lezhë është trajtuar në vijim:

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **28** rekomandime gjithsej, nga këto:

27 masa organizative dhe **11** masë zhdëmtimi me vlerën **5,884,616** lekë, **11** masa disiplinore, nga “vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, si dhe 4 masa për “largim nga puna”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 28 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 24, nga të cilat janë zbatuar 22 janë zbatuar pjesërisht 2 dhe nuk janë zbatuar 4 masa organizative.

Për shpërblim dëmi janë lënë 11 rekomandime për 69 raste me vlerë 5,884,616 lekë, të arkëtueshëm, nga të cilat, janë pranuar 4, janë zbatuar 4 rekomandime duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën 2,276 mijë lekë, mbetet në proces arkëtimi i vlerës prej 3,608 mijë lekë. Nuk janë konsideruar të zbatueshëm 3 rekomandime në vlerën 3,608 mijë lekë.

Në përfundim, rikërkojmë nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Lezhë përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 990/9, datë 01.03.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

II. A MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 2

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë, të marrë masa për përcaktimin e statusit juridik për ndryshimin e zërit kadastral, dhe problematika të tjera të trajtuara sipas dosjeve nr. 1757, nr. 35, nr. 252, nr. 436, nr. 31, nr. 2303, nr. 502, nr. 683, nr. 652, nr. 166, nr. 1240, nr. 166, nr. 719.

Menjëherë

Rekomandimi 4

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'ju kërkojë NJ.Q.V. vërtetimin mbi likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, dhe konkretisht për dosjet e legalizimit si më poshtë: *dosja nr. 23, datë 05.08.2006; dosja nr. 336, datë 28.08.2006; dosja nr. 3023, datë 17.11.2014; dosja nr. 22, datë 04.06.2006; dosja nr. 1038, datë 24.09.2014; dosja nr. 197/2, datë 10.03.2005; dosja nr. 1032, datë 24.09.2014; dosja nr. 1505, datë 03.10.2014; dosja nr. 16, datë 08.03.2005; dosja nr. 2043, datë 18.07.2013; dosja nr. 877, datë 03.07.2013; dosja nr. 806, datë 02.07.2013; dosja nr. 263, datë 11.09.2014; dosja nr. 275/3, datë 04.03.2005; dosja nr. 4425, datë 19.12.2014; dosja nr. 1833, datë 22.08.2006; dosja nr. 883, datë 03.07.2013; dosja nr. 450, datë 20.06.2013; dosja nr. 1451, datë 01.10.2014, dosja nr. 1462, datë 02.10.2014, dosja nr. 20, datë 11.06.2013; dosja nr. 3/35, datë 09.09.2006; dosja nr. 215, datë 17.06.2013; dosja nr. 2023, datë 18.07.2013; dosja nr. 2783, datë 27.10.2014; dosja nr. 1278, datë 01.10.2014; dosja nr. 32, datë 02.11.2006; dosja nr. 163, datë 03.10.2006; dosja nr. 172, datë 14.06.2013; dosja nr. 1217, datë 10.07.2013; dosja nr. 1442, datë 01.10.2014; dosja nr. 3285, datë 02.12.2014.*

Menjëherë

Rekomandimi 6

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

Rekomandimi 27

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, Sektori i Hartografisë dhe i Legalizimit, referuar detyrës funksionale dhe në zbatim të ligjshmërisë, rregullshmërisë, kritereve, procedurave dhe përgatitjes së dokumentacionit tekniko-ligjor të zbatueshëm për ndërtimin pa leje, të marrë masa për mbajtjen e akteve administrative të ndërmjetme dhe marrjen e vendimit të skualifikimit, për këtë dosje në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, VKM Nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", pika 2, germa "e", si dhe VKM nr. 995, datë 03.11.2010 "Për shpalljen "Rezervat natyror i menaxhuar" të ekosistemit natyror ligatinor të Patok-Fushë-Kuqe-Ishëm. pika 4, germa-b.

Menjëherë

II. B MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Rekomandimi 3

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë të marrin masa, duke ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës së penalitet për legalizimin e shtesave prej **1,930,208 lekë**, konkretisht personat: **L.K.** në shumën 449,231 lekë; **A.K.** në shumën 288,046 lekë; **P.L.** në shumën 164,715 lekë; **P.R.** në shumën 134,774 lekë; **Y.K.** në shumën 56,132 lekë; **Z.H.** në shumën 206,690 lekë; **N.T.** në shumën 280,745 lekë; **A.M.** në shumën 139,799 lekë; **F.G.J.** në shumën 212,076 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi 8

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Lezhë, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 488, datë 22.7.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës, Kreu I, pika 1 dhe 2, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **59,298 lekë** nga subjekti **F.G.J.**, ardhur si pasojë e llogaritjes gabim të tarifës së parcelës ndërtimore.

Menjëherë

Rekomandimi 11

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Lezhë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Lezhë, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore; për dosjen me vetëdeklarim nr. 395, datë 19.06.2013, pagesën e gjobës së pa arkëtuar prej **67,706 lekë** dhe dosjen me vetëdeklarim nr. 252, datë 22.03.2005, për pagesën e vlerës së sipërfaqes (mbi 300 m²), prej 200 m² x 8511 lekë/m² e barabartë me vlerën **1,702,200 lekë**, pasi ndodhet brenda vijës së verdhë qyteti Lezhë.

Menjëherë

II. C MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **kërkojmë Drejtorit Përgjithshëm të ALUIZNI Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Lezhë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje me shkrim**” deri në “**Largim nga puna**”, për këta punonjës:

“Largim nga Puna (zgjidhje e kontratës)”, për 2 punonjës si më poshtë:

1. z. **A.M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë dhe Çështjeve të Pronësisë nga data 01.04.2016.

2. Znj. **P.K.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës

Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga puna (zgjidhje e kontratës)”, për 11 punonjës si më poshtë:

1. Për z. **N.L.**, me detyrë Specialist

2. Për z. **A.SH.**, detyrë Specialist detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,

3. Për z. **M.P.**, detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,

4. Për z. **E.N.**, detyrë Specialist nga data 01.04.2014-në vazhdim,

5. Për z. **E.N.**, me detyrë Specialist nga data 26.01.2016-në vazhdim,

6. Për z. **L.N.**, me detyrë Specialist nga data 19.05.2014-në vazhdim,

7. Për z. **D.L.**, me detyrë Specialist nga data 28.01.2015-në vazhdim,

8. Për z. **G.J.K.**, me detyrë Specialist nga data 22.04.2015-në vazhdim,

9. Për znj. **D.G.J.**, me detyrë Specialist nga data 19.03.2014-në vazhdim,

10. Për z. **N.M.**, me detyrë specialisti i verifikimit në vazhdim

11. Për z. **R.M.**, me detyrë specialisti i verifikimit në vazhdim

Menjëherë

III. NË DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONA VE/NDËRTIMEVE INFORMALE QARKU GJIROKASTËR

Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale e ALUIZNI-t të Qarku Gjirokastrë është konstatuar se:

Në përfundim të Auditimit me shkresën nr. 765/13 datë 03.12.015, të Kryetarit të KLSH-së është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e ushtruar me programin nr. nr. 765/1, datë 19.08.2015.

Në zbatim të nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, dt. 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja me shkresën përcjellëse nr. 2034/1, datë 22.12.2015, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit. Në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria e ALUIZNI-t, Gjirokastrë nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga marrja e shkresës.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 35 rekomandime gjithsej, nga këto: 20 masa organizative dhe 7 masa zhdëmtimi me vlerën **11,322,667** lekë, 8 masa disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20 masa organizative**, nga të cilat, janë pranuar plotësisht **19** dhe janë në proces zbatimi **2** rekomandime, është ezuaruar **1** rekomandime për shkak të ndryshimeve ligjore, si dhe nuk është pranuar, njëkohësisht nuk ka gjetur zbatim **1** rekomandim.*

*Për shpërblim dëmi janë lënë **7** rekomandime për shumën **11,322,667** lekë të arkëtueshëm, nga të cilat, janë pranuar **6**, janë zbatuar pjesërisht **5** duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën **218,627** lekë, mbetet në proces arkëtimi i vlerës **prej 7,519** lekë. Nuk është konsideruar i zbatueshëm **1** rekomandim në vlerën **3,584,364** lekë.*

Në përfundim **rikërkojmë** nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Gjirokastrë përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 765/13 datë 03.12.015, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

III.A MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 6

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të marrë masa dhe të ndjek procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit e parcelës ndërtimore, për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit në **11 praktika** me sipërfaqen **7537.5** m², për saktësimin dhe arkëtimin e të ardhurave në vlerën **22,817,868** lekë.

Menjëherë

III.B MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 6

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Gjirokastrë të marrë masa, për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës të **142 personave me vlerë 3,584,364** lekë, të cilët nuk kanë bërë të mundur likuidimin e kësaj takse.

Menjëherë

III. C MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, **141, dhe 153** të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **kërkojmë Drejtorit Përgjithshëm të ALUIZNI Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Gjirokastrë duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “**Vërejtje**” deri në “**Zgjidhjen e kontratës së punës**”,

1. Z. **R.GJ.** me detyrë specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.
2. Z. **N.XH.** me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.
3. Znj. **B.T.** me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.
4. Z. **I.B.** me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.
5. Znj. **F.Ç.** me detyrë specialiste faturash, pranë Sektorit të Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

Menjëherë

IV. NË DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE, TIRANA - 2

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë e ALUIZNI-t TIRANA-2 është konstatuar se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1256/12, datë 30.04.2017, ka dërguar në Drejtorinë e ALUIZNI-t TIRANE-2 dhe me nr. 1252/13 datë 30.04.2017 në Drejtorinë Përgjithshme ALUIZNI-t Tiranë, Raportin Përfundimtar të Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. Me urdhrat nr. prot. 97 dhe nr. 107 datë 20.07.2017 nga Drejtori e ALUIZNI-t TIRANE -2 është ngritur Grupi i Punës për zbatimin e detyrave të rekomanduara. Është plotësuar *Hartimi i planveprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

Nga Drejtoria e ALUIZNI-t TIRANE -2, në zbatim të rekomandimeve sipas shkresës nr. 1256/12, datë 30.04.2017 të KLSH “Raporti Përfundimtar i Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse.” në zbatim me ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 30, pika 2, është dërguar informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Drejtoria e ALUIZNI-t TIRANE -2 me shkresën nr. 3689/27, datë 15.05.2017 “Informacion mbi Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet të auditit të KLSH-së” ka informuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, së bashku me masat disiplinore të mara. *Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Drejtorinë e ALUIZNI-t TIRANE -2*

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me “Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga 01.08.2014 deri në 31.12.2016. Në Drejtorinë e ALUIZNI-TIRANE-2 është trajtuar në vijim:

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **21** rekomandime gjithsej, nga këto:

18 masa organizative dhe **3** masë zhdëmtimi me vlerën **51,142** lekë, **8** masa disiplinore, nga “vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”,

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **18** masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 12 dhe janë ezuaruar 12 rekomandime, për 6 rekomandime nuk janë pranuar për shkak të ndryshimeve ligjore, si dhe kompetencave territoriale.*

Për shpërblim dëmi janë lënë 3 rekomandime për 3 raste me vlerë 51,142 lekë, të arkëtueshëm, nga të cilat, nuk janë pranuar 3, janë pazbatuar 3 rekomandime.

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tirana 2 përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1256/12, datë 30.04.2017, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

IV.A MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 2

Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2 të marrë masa, për të gjitha objektet informale të cilat nuk plotësojnë kriteret për legalizim, të ndiqen procedurat, për shkualifikimin e tyre nga procesi i legalizimit dhe të njoftohen aplikuesit si dhe Bashkia Tiranë, për tu trajtuar si ndërtime të paligjshme që nuk përfshihen në legalizim.

Menjëherë

Rekomandimi 3

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa duke ndjekur rrugët ligjore për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar dhe marrjen e masave që në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të mundësohet daljen e VKM për shpronësim të parcelave ndërtimore të 115 objekteve të legalizuara në një vleftë të parcelave ndërtimore prej 22,082,031lekë.

Menjëherë

Rekomandimi 4

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 2 në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

Rekomandimi 5

Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që për 16 rastet e konstatuara të plotësohet "Proces verbal i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa lejë/shtesës në ndërtimin me leje", me largësitë e bazës së objektit nga kufijtë e parcelës ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Në rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim, me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

Rekomandim 10

Drejtoria ALUIZNI Tirana 2 të marrë masa të menjëhershme për të administruar dhe mbajtur evidencë të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkresat në lidhje me statuset juridike të pasurive, afatet e trajtimit të tyre, përgjigjet e dhëna nga ZVRPP si dhe problematikat e hasura në vazhdimësi, duke i shërbyer në këtë mënyrë mbarëvajtjes së procesit të legalizimit.

Menjëherë

IV. B MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1

Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të neneve 23, 27 dhe 43 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, si dhe me VKM nr. 1180, datë 5.8.2008 "Për përcaktimin e vlerës së tarifës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit" e ndryshuar të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës 21,149 lekë nga subjektit "G"** e ardhur si pasojë e mos pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për 7,408 lekë si dhe penalitetit për ndërtime mbi lejen e miratuar për 5,741 lekë si dhe tarifë shërbimi për 8,000 lekë.

Menjëherë

Rekomandimi 2

Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 2, të marrë masa që në zbatim të kërkesave të nenit 43 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës 14,258 lekë nga subjektit "F"** e ardhur si pasojë e mos aplikimit penalitetit për ndërtime mbi lejen e miratuar.

Menjëherë

Rekomandimi 3

Drejtoria e ALUIZNI-t Tiranë 2, të marri masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 15,735 lekë nga subjekti "A-I-C", ardhur nga mos aplikimi i penalitetit për sipërfaqen prej 9.8 m², tej lejes së ndërtimit.

Menjëherë

V. NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Nga auditimi u konstatua se:

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 813/10, datë 26.12.2016, ka dërguar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe me nr. 813/11, datë 26.12.2016 në Ministrinë e Drejtësisë, Raportin Përfundimtar të Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. *Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Me shkresën nr. 2996/125, datë 16.01.2017 "Dërgim planin e masave mbi rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar", ka nisur planin e punës për zbatimin e rekomandimeve të rekomanduara.

Nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të rekomandimeve sipas shkresës nr. 813/10, datë 26.12.2016 të KLSH "Raporti Përfundimtar i Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse." në zbatim me ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenit 30, pika 2, është dërguar informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit nga Agjencia e Trajtimit të Pronave me shkresën nr. 2996/128, datë 23.06.2017 "Mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në Raportin Përfundimtar, ka informuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, së bashku me masat disiplinore të mara.

Analizimi dhe nxjerrja e përgjegjësive në Agjencinë e Trajtimit të Pronave

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me "Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2014 deri në 30.06.2016. Në Agjencinë e Trajtimit të Pronave është trajtuar në vijim:

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **62** rekomandime gjithsej, nga këto:

56 masa organizative dhe **6** masë zhdëmtimi me vlerën **125,854,404 lekë**, 24 masa disiplinore, nga "vërejtje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punës".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 56 masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 54 dhe janë ezuaruar Në vazhdimësi, 2 rekomandime nuk janë pranuar e zbatuar për shkak të ndryshimeve ligjore.

Për shpërblim dëmi janë lënë 6 rekomandime me vlerë 125,854,404 lekë, të arkëtueshëm, nga të cilat, nuk janë pranuar 6, janë zbatuar 1 rekomandime por nuk ka arkëtime.

Në përfundim rikërkojmë nga Agjencia e Trajtimit të Pronave përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 813/10, datë 26.12.2016, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara.

V. A MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 44

ATP (ish AKKP) Tiranë, të marrë masa dhe t'i kërkojë ZVRPP Tiranë kufizimin e pasurisë përfituar nga subjekti B. Ç. deri në saktësimin e dokumentit të pronësisë si dhe kthimin e sipërfaqes tepër prej 14.6 m² pjesë e pasurisë shtet nr. 1/304, zk. 8180 të përfituar padrejtësisht.

Menjëherë

V. B MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1

Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës 74,388,975 lekë, që i përket 20 rasteve të tjetërsimit më tepër të truallit me sipërfaqe totale 4691.1 m², në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar padrejtësisht nga personat përkatës, sipas tabelës bashkëlidhur, dhe konkretisht si më poshtë:

- **A. M. shumën 2,805,000 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 330 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 3, datë 19.01.2015.**
- **M. M. shumën 740,324 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 299 m², të përfituar padrejtësisht më tepër, sipas Vendimit të ATP-së nr. 9, datë 28.01.2015, ndryshuar me Vendimin nr. 34, datë 18.03.2015.**
- **A. H. shumën 8,384,425 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 12, datë 19.02.2015.**
- **S. M. shumën 2,307,400 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 278 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 14, datë 19.02.2015.**
- **L. O. shumën 5,509,650 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 230 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 36, datë 18.03.2015.**
- **R. A. shumën 4,368,100 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 220 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 41, datë 23.03.2015.**
- **L. K. shumën 4,145,177,00 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 231.6 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 4, datë 22.01.2015.**
- **J. B. shumën 5,369,400 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 25, datë 04.03.2015.**
- **V. D. shumën 3,529,028 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 92 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 45, datë 27.03.2015.**
- **I. Ç. shumën 876,148 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 83 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 56, datë 07.04.2015.**
- **Xh. Z. shumën 8,000,970 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 334 m², të përfituar padrejtësisht më tepër, sipas Vendimit të ATP-së nr. 65, datë 09.04.2015.**
- **Sh. M. shumën 5,369,400 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 72, datë 30.04.2015.**

- **M. K. shumën 3,694,600 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 367, datë 30.04.2015.
- **B. O. shumën 916,750 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 250 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 368, datë 30.04.2015.
- **K. P. shumën 5,936,645 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 299 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 380, datë 18.06.2015.
- **Sh. P. shumën 3,166,800 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 381, datë 25.06.2015.
- **D. B., A. B., I. B. dhe L. B. shumën 9,269,158 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 444.5 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimeve të ATP-së: nr. 57, datë 8.04.2015; nr. 58, datë 8.04.2015; nr. 59, datë 8.04.2015; nr. 60, datë 8.04.2015.

Menjëherë

Rekomandim 2

ATP (ish AKKP) Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **22,458,705 lekë**, që i përket **7 rasteve të tjetërsimit më tepër të truallit me sipërfaqe totale 1612.2 m²**, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar nga personat si më poshtë:

- **M. A. shumën 9,143,947 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 304.2m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 395, datë 20.07.2015;
- **B. Ç. shumën 360,708lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 12m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 397, datë 20.07.2015;
- **Z. D. shumën 558,000lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 445, datë 23.10.2015;
- **N. T. shumën 4,963,750lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 250m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 420, datë 27.08.2015;
- **Q. L. shumën 1,789,800lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 100m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 470, datë 13.11.2015;
- **A. P. shumën 2,625,700lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 401, datë 20.07.2015;
- **L. H. shumën 3,016,800lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 466, datë 13.11.2015;

Menjëherë

Rekomandim 6

Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **26,503,914 lekë**, që i përket **10 rasteve të tjetërsimit më tepër të truallit me sipërfaqe totale 1,203.3 m²**, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar nga personat, pasqyruar më poshtë:

- **F. K., shumën 2,924,385 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 95 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 66, datë 10.06.2016.
- **K. T., shumën 2,050,466 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 229 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 14, datë 16.02.2016.
- **M. B., shumën 1,165,260 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 17.4 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 2, datë 16.02.2016.
- **M. C., shumën 4,327,768 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 138.4 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 65, datë 09.06.2016.
- **M. K., shumën 2,185,920 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 80 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 69, datë 23.06.2016.
- **R. Gj., shumën 936,570 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 30 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 61, datë 09.06.2016.
- **E. S., dhe B. S. shumën 4,003,581 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 367.2 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimet të ATP-së nr. 26 dhe 27, datë 16.02.2016.

- **N. B.**, shumën 7,180,370 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 230 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 28, datë 27.04.2016.
- **A. G.**, shumën 1,099,594 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 16.3 m², të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 29, datë 27.04.2016.

Menjëherë

VI. DREJTORIA RAJONALE E ALUIZNI-t KORÇË

Është dërguar nga KLSH-it me shkresë përcjellëse **24** rekomandime gjithsej, nga këto: **20** masa organizative dhe **4** masë zhdëmtimi me vlerën **763,316** lekë, **9** masa disiplinore, nga "Vërejtje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punës", si dhe **4** masa për "Largim nga puna".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **20** masa organizative, nga të cilat, janë pranuar plotësisht 20 dhe janë ezuaruar 17 rekomandime, për 3 rekomandime vazhdon puna në proces kjo edhe për shkak të ndryshimeve ligjore.*

*Për shpërblim dëmi janë lënë **4** rekomandime për **4** raste me vlerë **763,316** lekë, të arkëtueshëm nga të cilat, janë pranuar 3, janë zbatuar 3 rekomandime duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën **663,316** lekë, është zbatuar pjesërisht 1 duke arkëtuar detyrimin financiar në vlerën **100,000** lekë.*

Masat disiplinore janë zbatuar plotësisht në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, e cila ka kompetencën ligjore për këto masa.

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË USHTRUAR NË 6 SUBJEKTE "MBI ZBATIMIN E MASAVE TË REKOMANDUARA NË AUDITIMET E USHTRUAR PËR PERIUdhËN TREMUJORI I 4-TE I VITIT 2016 DERI MË 9 MUJORI I VITIT 2017".

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, në auditimet e evaduara për periudhën 2016 - 2017, sipas programit të auditimit nr.1080/1, dt. 23.10.2017, dhe në përputhje me kërkesë të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së, nr. 1 datë 4.11.2016 "*Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në 6 subjekte të auditura ka rezultuar si më poshtë :

- Janë rekomanduar gjithsej **212** masa, nga të cilat janë pranuar **100%** e masave të lëna në subjekte.

a- zbatuar plotësisht **85** masa, ose 40 %, pjesërisht **20** masa ose 10%, në proces zbatimi **8** masa, ose 4 % , **97** masa disiplinore të pazbatuara, ose 46%.

b.Niveli i realizimit të masave, sipas llojit paraqitet si më poshtë:

b. 1. Masa përmirsim ligjor janë rekomanduar **2** .

b.2. Masa organizative, janë rekomanduar **131**.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve rezulton: zbatuar plotësisht **85** masa, ose 64 %, pjesërisht **12** masa ose 9% në proces zbatimi **9** masa,ose 7 % dhe **27** masa të të pazbatuara, ose 20%.

b.3. Masa shpërblim dëmi, nga **5** masa të rekomanduara, janë pranuar **5** masa.

Zbatimi në vlerë është si vijon: **5** masa të rekomanduara **me vlerë 3,452 mijë lekë**, janë pranuar **100%**, në vlerë **3,452 mijë lekë** ose 100%, janë zbatuar pjesërisht 3 masa me vlerën **719 mijë lekë** ose 21%, dhe janë pazbatuar (paarkëtuar) **2** masa me vlerë **2,733 mijë lekë, ose 65.7%**.

Konstatohen se 4 subjekte nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Bazuar në këto rezultate të lidhura me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve e Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Projektvendim “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm”, të ushtruar në 6 subjektet të audituara në periudhën 30.06.2015 – 31.12.2017.

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për të gjithë subjektet e audituara, si më poshtë:

1. NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT, GJIROKASTËR

Nga auditimi i ushtruar në DRM Gjirokastrë , për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën nga 01.01.2014 deri në 31.12.2016, trajtuar në Vendimin nr.54 datë 19.05.2017 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 191/7 datë 19.05.2017, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRM Gjirokastrë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 620 datë. 27.07.2017, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRM Gjirokastrë ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 18 rekomandime gjithsej, nga këto: 16 masa organizative, 2 masa zhdëmtimi me vlerën 528 mijë lekë dhe 6 masa disiplinore (nga të cilat 6 masa “vërejtje” .

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 16 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 16, janë zbatuar 9 dhe janë në proces zbatimi 3 rekomandime të pa realizuara 4.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë 1 rekomandime për shumën 528 mijë lekë, nga të cilat, janë pranuar dhe arkëtuar në vlerën 218 mijë dhe është në proces zbatimi rekomandimi për vlerën 310 mijë lekë.

c. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore “Vërejtje”, nga të cilat 6 masa janë pranuar , por nuk është zbatuar asnjë masë e dhënë.

Në përfundim të rikërkojmë nga DRM Gjirokastrë, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 1: DRM Gjirokastrë, të marrë masat që në fillim të çdo viti kalendarik të bëjë parashikimin e të ardhurave, në bazë të të ardhurave të vitit paraardhës sipas ligjit të buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 pika ç.

Rekomandim 2: DRM Gjirokastrë, të marrë masa për njoftimin e të gjithë operatorëve të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarkun e Gjirokastrës, të pajisur me leje mjedisi tipi C apo që kërkojnë të pajisen me leje mjedisi tipi C, që në përshkrimin e mandat pagesës të përfshihet lloji i tarifës së paguar, emri i subjektit për të cilin kryhet pagesa dhe vendndodhjen e instalimit për të cilin kryhet pagesa. DRM Gjirokastrë, të mos pranojë pagesa të cilat nuk i përmbahen këtij formati, i cili është një formë e eliminimit të mundësisë së pagesës së një tarife për disa instalime nga i njëjti subjekt.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1: DRM Gjirokastrë në bashkëpunim me DRISHMP Gjirokastrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **134,000** lekë, ndaj subjekteve debitorë, të cilët kanë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe nuk kanë paguar tarifën vjetore për lejet e mjedisit tipi C.

Rekomandim 2: DRM Gjirokastrë në bashkëpunim me DRISHMP Gjirokastrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **130,000** lekë nga subjektet të cilët nuk kanë bërë pagesën për shqyrtimin e kërkesës për leje mjedisi tipi C.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr. 47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, **i rikërkojmë Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorin të Përgjithshëm të AKM Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për:

1. **Z. S.R** me detyrë drejtor i DRM Gjirokastrë,
2. **Z. J V**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis,
3. **Z. P.Sh**, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis,
4. **Znj. V.G**, me detyrë specialiste Vlerësimi Ndikimi në Mjedis,
5. **Z. K.Dh** me detyrë specialist Monitorimi,
6. **Znj. E. D**, me detyrë Specialiste e Financës.

2. NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT, FIER

Nga auditimi i ushtruar në DRM Fier, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*” për periudhën nga 01.01.2014 deri në 31.12.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. sipas Vendimin nr. 31 datë 25.04.2017 DRM Fier, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, DRM Fier nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **39** rekomandime gjithsej, nga këto: 2 masa përmirsim ligjor, 29 masa organizative dhe **1** masë zhdëmtimi me vlerën *866,000 lekë*, 1 MASË te ardhura të munguara 7 masa disiplinore “Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **29 masa organizative**, të cilat janë pranuar plotësisht **29**, nga të cilat janë zbatuar **15 pjesërisht 6**, rekomandime **8** të pa realizuara .

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria Rajonale e Mjedist Fier, përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Rekomandim 1. Nga auditimi në DRM Fier, përperiudhën 2014, 2015 dhe 2016, lidhur me zbatimin e procedurave ligjore, plotësimin e dokumentacionit dhe argumentimin ligjor të Akt Refuzimeve për Leje Mjedisi Tipi C, konstatuam mangësi në plotësimin e dokumentacionit si: ngatërrimet e emërtimeve të adresave të administratorëve/pronarëve të subjekteve, me adresën e vendndodhjes së ushtrimit të veprimtarisë së biznesit; ngatërrim të numrit të pasurive ku ushtrohet aktiviteti, me numrat e zonës kadastrale; parregullsi dhe mosargumentim ligjor të refuzimeve. Kryesisht u konstatuan formulime të kushteve me fjalë të përgjithshme, kërkesa të paplotësuara dhe mungesë të bazës ligjore, shoqëruar me mosndjekje e mosevidentim në vazhdimësi të procedurave dhe afateve që kanë sjellë **vonesa nga 1 muaj deri 28 muaj, në kundërshtim me afatet procedurale maksimale (prej 16 ditë pune ose 24 ditë kalendarike), mosndjekje e mosevidentim në vazhdimësi të refuzimeve të përsëritura kryesisht me mosplotësim kriteresh të rëndësishme për mjedisin duke u dhënë përparësi kriterëve të urbanistikës, gjendje kjo në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL”, trajtuar në tabelën emërtuar “Tabela e refuzimeve të lejeve tip C afatet e trajtimit, aktkontrollet, shkaqet DRM Fier viti 2014, 2015 dhe 2016”, bashkëlidhur raportit.**

Rekomandim 2. DRM Fier, në periudhën 2014, 2015 dhe 2016 ka lejuar vendimmarrjen për leje të tipit C pa miratimin e NJQV-ve, praktikë e konstatuar në **560 raste** (nga **782 raste**) nga të cilat në **203 raste (nga 425 dërgesa) për mos kthim** përgjigje brenda afatit treditore nga NJQV-të dhe në **357 raste nga mos dërgimi i kërkesës** për mendim në NJQV, në kundërshtim me kreu IV pika 3 dhe me afatet e procedurës sipas pikës 2, pika 4 dhe pika 5 e VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit, si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Tabela e Njoftimeve të DRM Fier të Aplikimeve për tërheqje Mendimi (konfirmimi) nga NJQV për lejet Tip C dhe përgjigjet nga NJQV-të” sipas viteve, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga analizimi i praktikave, kemi arritur në konkluzionin se afati prej treditore për kthim përgjigje nga NJQV, është jo funksional dhe lejimi i vazhdimin të procedurës nga DRM-ja sipas pikës 4 edhe në mungesë të përgjigjes së NJQV, sjell si pasojë përjashtimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje të NJQV, megjithëse pasojat mjedisore bien mbi të.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 2: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e praktikës: Akt Refuzim/Miratim në aktrefuzimin nr.36 për subjektin M.Xh. ndodhur rruga Fshat Dukas-Patos akti nr.409, datë 17.06.2016, aplikim datë 10.6.14, ku konstatohet mungesa e lejes urbanistike dhe planvendosjes nga Bashkia Patos. DRM Fier të shfuqizojë rekomandimin për betonim, të kërkojë vendosjen e kriterit distancë nga rrugët apo qendra e banuar për këtë aktivitet, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulojë lejen e dhënë dhe të njoftojë DRISHMP Fier.

Rekomandim 3: DRM Fier, Drejtori të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit sipas përcaktimeve të vendosura në Urdhrin e AKM nr. 38, datë 17.03.2015”Për Krijimin dhe Funksionimin e Komisionit Teknik për Verifikimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi C në Qarqe”.

Të eliminohet praktika e punës me fushata në fund të periudhave tre mujore, duke synuar një programim të kujdesshëm jo vetëm të problematikave por edhe të burimeve njerëzore në dispozicion.

Rekomandim 7: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e **5 rasteve** (praktikave) të Akt Miratimeve të lëshuara në vitin 2015, me mungesë dokumentacioni që i përkasin pikave të karburantit të subjektit “S...P... Albania”, sa shprehur me sipër, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulojë lejet e lëshuara dhe të njoftojë DRISHMP Fier.

Rekomandim 8: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin e **5 raste leje të Tipit C** praktikave të Akt Miratimeve të lëshuara viti 2015 me mangësi e përcaktime të pasakta në formulim e në përmbajtje të kushteve të lejeve mjedisore, të saktësojë me NJQV-të, riformulojë përmbajtjen e kushteve, të heqë kushtet e vendosura tej kompetencave të DRM dhe të rishkruajë lejet e sakta, si dhe pasi të anulojë tërheq ato me mangësi të pajisë mbajtësit me lejet e rregullta sikundër trajtuar në faqet e projektraportit përkatësisht:

- subjektin “P...”, Akti miratimit LC- 1978, datë 21.4.2015, me aktivitet Furrë Buke për 3 kushte;
- subjektin E..Ç, Akti miratimit LC- 4741, datë 02.09 2015, aktivitet Furrë buke 2 kushte”;
- subjektin A.S, Akti miratimit LC- 3111, datë 10.06.2015 (22.05.15), me aktivitet Riparim Makina, për 2 kushte;
- subjektin D.Z, Akti miratimit LC- 2430, datë 18.05.2015 me aktivitet Furrë buke me 3 kushte;
- subjektin Ç.. shpk, Akti miratimit LC- (3364 ose 3365), datë 18.06.2015 me aktivitet pikë karburanti, për 1 kusht.

Rekomandim 9: DRM Fier të marrë masa për rishqyrtimin elejes të Tipit C në vitin 2015, për subjektin Z.Z Akti miratimit LC- 4944, datë 09.09.15 me aktivitet Bar-kafe-restorant Lokal nate me muzikë live, për aktivitet të pjesshëm (vetëm për Muzikë Live) dhe në shkëlje të kushtit të distancës për zhurmën (me distancë 5 ml nga 150 ml në fakt), për shkakun e shprehur se distanca është 150 ml nga banesa më e afërt, kurse sipas aktkontrollit në terren kjo distancë është rreth 5 ml, fakt që tregon kundërshti në deklaratimet e bëra.

Rekomandim 14: Drejtorja Rajonale e Mjedisit, Qarku Fier, (Drejtori dhe komisionet), të hartojë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar proces-verbalet dhe aktet e miratimit të kërkesave për leje mjedisi tipi “C”. Për serviset e automjeteve që bëjnë ndërrim vajrash, të vihet kushti për të kërkuar kopjet e kontratës me kompaninë që grumbullon Vajrat.

Rekomandim 26: DRM Fier duhet të kryejinventarizimin e pasurisë dhe vlerën e aktiveve në administrim të institucionit, në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.2.2011 “Për Menaxhimin e

Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, si dhe të bëjë inventarizimin e plotë të pasurisë së saj dhe të bëhet kontabilizimi i veprimeve sipas SKK.

Rekomandim 28: DRM Fier të marrë masa e kërkojë nga komisioni i vlerësimit të ofertave për çdo rast për blerjet me “vlerë të vogël”, të kryejë inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të praktikave sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr.4, datë 04.07.2013.”Për blerjet me vlerë të vogël.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Fier, të marrë të gjitha masat që subjektet që janë debitorë të bëjnë arkëtimin e shumës në vlerën prej **422,000** lekë.

D. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.47, datë 29.01.2014 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të Agjencive Rajonale të Mjedisit”, **i rikërkojmë Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorin të Përgjithshëm të AKM Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për:

1. *Për z. E. Z*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis,
2. *Për z. Dh. B*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis,
3. *Për z. E. B*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis,
4. *Për znj. A. K*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis,
5. *Për znj. E. B*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis,
6. *Për z. B. F*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis,
7. *Për zj. V. G*, me detyrë specialiste e monitorimit.

3. NË DREJTORINE RAJONALE TË MJEDIST DHE PYJEVE, KUKËS

Nga auditimi i ushtruar në DR ISHMP Kukës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*” për periudhën 01.01.2015 deri 30.05.2017 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. nr. 66 datë 24.06.2017 të Kryetarit të KLSH-së.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, DR ISHMP Kukës ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 203/1, datë 14.07.2017, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, DR ISHMP Kukës nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga data e marrjes së shkresës pasi nuk ishte plotësuar afati 6 mujor.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **46** rekomandime gjithsej, nga këto: **22** masa organizative **1** masa zhdëmtimi me vlerën *3,495 mijë lekë*, 4 masa të ardhura të munguara si dhe 19 masa disiplinore, (në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil",

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **22** masa organizative dhe janë pranuar plotësisht **22**, nga të cilat janë zbatuar 15, janë në proces zbatimi 5 rekomandime. Dhe të pa realizuar 2 masë organizative.
- b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë 1 rekomandim për shumën **3,945 mijë** lekë, e cila është pranuar dhe nuk është zbatuar .
- d. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil",

Në përfundim rikërkojmë nga DR ISHMP Kukës, *përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht.*

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandim11 : DR ISHMP Kukës të marrin masa, të hartojë program të posaçëm për zbatimin e procedurave ligjore të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vendosura, duke bërë të mundur rritjen e nivelit të vjeljes së gjobave dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e ecurisë së procedurave ligjore

Rekomandim 20.:DR ISHMP Kukës të marrë masa për hartimin, miratimin dhe zbatimin e Dokumentit të Strategjisë dhe Planin strategjik, në zbatim të procedurave përkatëse, duke përcaktuar qartë tregues të matshëm, krahasueshëm, etj, për të mundur matjen e realizimit në periudhat përkatëse. Kjo me synimin që ky dokument të bëhet funksional në shërbim të ngritjes së treguesve të tjerë dhe në argumentim të hartimit zbatimit të PB dhe PBA, në përmbushje të:

- a. Objektivave të Programit përkatës të Qeverisë në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit të Qëndrueshëm të Mjedisit,
- b. Legjislacionit përkatës në fushën Mjedisit, së bashku me strategjitë zhvillimore në fushat përkatëse, hartuar nga institucionet menaxhuese, Ministria e Mjedisit dhe ministritë e tjera, konventat ndërkombëtare në planet dhe programet e NJVQV-ve, shoqatave dhe aktorëve të tjerë, si dhe në raportet e vlerësimit të gjendjes mjedisit mbështetur në burimet si:

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA

Rekomandim 3: DR ISHMP të marrë masa për vjeljen e gjobave, duke ju drejtuar zyrës së përmbaruesit privat për periudhën 2015-2016, e cila ka sjellë mungesë të evidentimit, kontabilizimit dhe menaxhimin financiar dhe kontrollit për ecurinë e procedurave të procesit administrativo ligjor.

Rekomandim 4: DR ISHMP Kukës të marrë masa, për tu kthyer në titull ekzekutiv në gjykatë, në mënyrë që të bëhet vjelja dhe kontabilizimi i këtyre gjobave.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1: DR ISHMP Kukës të marrë masa për të arkëtuar vlerën **3,945 mijë lekë**, duke nxjerrë përgjegjësitë direkte të punonjësve, duke njoftuar KLSH për realizimin e këtij rekomandimi.

D. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rikërkojmë Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit, Kryeinspektorin të ISHMP-së Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës me status të nëpunësit civil, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore me **“Vërejtje”** për:

-Për z. **D B**, me detyrë Kryeinspektor .

C/2 . Nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga shërbimi civil”** , për punonjësit e mëposhtëm:

-Për z. **P. A**, me detyrë Specialist finance,

Specialistë të sektorit të Mjedisit:

- **Për z. L. D** me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

- **Për z.. S. M**, me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

- **Për z. E.D**,me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

C/3. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit” **i rikërkojmë Kryeinspektorin ISHMP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe të marr masa disiplinore nga **“Vërejtje me paralajmërim”** për punonjësit e mëposhtëm :

- **Për z. S.H**,me detyrë Pergjegjës i sektorit të Polocisë Pyjore,

- **Për z. I. T**,me detyrë Pergjegjës i sektorit të Polocisë Pyjore,

- **Për z. N, P**,me detyrë Pergjegjës i sektorit të Polocisë Pyjore,

Inspektorë në sektorin e Policisë Pyjore,

-**Për z.A. M**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve ,

- **Për z. F. D**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z. M. S**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z. K. N**,me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z.A.U**,me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z. Xh. D**, me detyrë innspektor në sektorin Pyjeve

- **Për z. L.P**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z .P. S**,me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve ,

- **Për z .I.K**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

- **Për z. I. M**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve ,

- **Për z .B. Gj**, me detyrë innspektor në sektorin e Pyjeve,

4. NË DREJTORINE RAJONALE TË MJEDIST DHE PYJEVE, LEZHË

Nga auditimi i ushtruar në DR ISHMP Lezhë , për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit*” për periudhën 01.01.2015deri 31.12.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 56, datë 29.05.2017 të Kryetarit të KLSH-së .

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, DR ISHMP Lezhë nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, DR ISHMP Lezhë nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 21 rekomandime gjithsej, nga këto: 19 masa organizative, 1 masa zhdëmtimi me vlerën 1,143mijë lekë, 1 masë të ardhura të munguara në vlerë 51,00 0mijë lekë si dhe 19 masa disiplinore (nga “*vërejtje*” deri në “*Zgjidhje të kontratës së punës*”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. *Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 19 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 19 janë zbatuar 12, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 4 rekomandime.*
- b. *Për shpërblim dëmi janë lënë 1 rekomandime për shumën 1,143 mijë lekë, e cila është e pa realizuar.*
- c. *Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil",*
- d. *Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës ’’.*

Në përfundim rikërkojmë nga DR ISHMP Lezhë përsheptimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

A. MASA ORGANIZATIVE.

Rekomandim 7: DR ISHMP Lezhë të marrë masat, që autorizimet e nxjerra nga Kryeinspektor dhe përgjegjësi i sektorit të Pyjeve, të hartojnë autorizime mbi bazë analizash dhe vlerësim rrisht.

Rekomandim 10: DRISHMP Lezhë të marrë masa, për të programuar kontrole të vazhdueshme dhe të hartojë plane konkrete, duke i dhënë përparësi inspektimit në fushën e mjedisit, në zonat turistike, zonat e mbrojtura dhe zonat arkitekturore, që ndodhen në Qarkun e Lezhës, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e cilësisë mjedisore të këtyre resurseve turistike.

Rekomandim 11: DRISHMP Lezhë të marrë masa dhe të hartojë program të posaçëm për zbatimin e procedurave ligjore të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vendosura, për periudhën 2015-2016, për një nivel të ulët të vjeljes së gjobave, mungesë të evidentimit, kontabilizimit dhe menexhimit financiar dhe kontrollit të ecurisë së procedurave ligjore të procesit administrativo ligjor

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA

Rekomandim 1 : DR ISHMP Lezhë të marrë masa, për të monitoruar dhe programuar kontrole më të shpeshta të subjekteve, që përmbajnë risk më të lartë lidhur me shkeljet në fushën e mjedisit, si dhe të rikontrollohen të gjithë subjektet që janë klasifikuar me shkelje të dispozitave ligjore, duke përcaktuar nëse është bërë korrigjimi i parregullsive të konstatuara. Në çdo rast të

konstatimit të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore, të zbatohen masa administrative “ Dënim me gjobë”, për subjektet kundravajtëse sipas përcaktimeve ligjore .

Rekomandim 2: Kryeinspektori i DR ISHMP Lezhënë bashkëpunim me juristin e Institucionit dhe strukturat përkatëse, të marrë masa për të rivendosur në afat procedurën e kthimit në titull ekzekutiv për 32 masa administrative në vlerën prej 11,150 mijë lekë, si dhe të ndjekë në vazhdimësi e të rrisë praninë në proceset gjyqësore, me qëllim ndjekjen deri në fund të zbatimit të akteve administrative, sidomos ato që kanë të bëjnë me gjoba për vjeljen sa më shpejt të tyre.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandim 1: DR ISHMP Lezhe të marrë masa për të arkëtuar vlerën 1,443 mijë lekë, duke nxjerrë përgjegjësitë direkte të punonjësve, duke njoftuar KLSH për realizimin e këtij rekomandimi.

D. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, i rikërkojmë Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit dhe Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës me status nëpunësit civil , fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”.

1-Për z. A. L, me detyrë specialist i financës,

2- Për z. K. S, me detyrë specialist i sektorit Juridike,

3- Për z. B. S, me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit,

4- Për z. K. L, me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

5- Për z. T. P, me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

6- Për z. H. N, me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit,

7 - Për z. A. M, me detyrë innspektor në sektorin e Mjedisit.

C/2. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i rikërkojmë Kryeinspektorit ISHMP Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë, “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për punonjësit.

1. Për z. A. D, me detyrë Përgjgjës i sektorit të Policisë Pyjeve,

2. Për z. M. K, me detyrë inspektor,ePyjeve ,

3- Për z. G. B , me detyrë inspektore Pyjeve ,

4- Për z. F. D, me detyrë inspektor nw sektorin e Pyjeve ,

5- Për z. G. Gj, me detyrë inspektor nw sektorin ePyjeve,

6- Për z. M. D, me detyrë inspektor nw sektorin e Pyjeve,

7- Për z. A.LL, me detyrë inspektor nw sektorin e Pyjeve,

8- Për z. A. N, me detyrë inspektor e Pyjeve,

9- Për z. E. K, me detyrë inspektor e Pyjeve,

10-Për z. Q. S, me detyrë inspektor e Pyjeve.

5. NË DREJTORINE RAJONALE TË MJEDISIT DHE PYJEVE **.SHKODËR**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit dhe Pyjeve Shkodër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë e vlerësues i aktivitetit të institucionit” për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2016, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 156 datë 24.12.2016 të Kryetarit të KLSH-së Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Pyjeve Shkodër ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 20 ditëve, me shkresën përcjellëse nr. 15.01.2017, me njoftim për hartimin e programit të punës me rekomandimet e dhëna, marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH, personat përgjegjës dhe afatet e zbatimit.

Në zbatim të pikës 2, neni 30, të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Pyjeve Shkodër ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve, me shkresën përcjellëse nr. 1026/3, dt. 30.06.2017, me njoftim për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë **26** rekomandime gjithsej, nga këto: **25**masa organizative, **1** masë zhdëmtimi me vlerën **61,215** lekë dhe **14** masa disiplinore nga te cilat 7 masa Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil",

Si dhe 7 masa disiplinore me vërejtje me paralajmrim (Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës nga “Vërejtje me paralajmërim” deri “Zgjidhje të kontratës së punës”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **25 masa organizative**, të cilat, janë pranuar plotësisht **25**, nga të cilat janë zbatuar **21**, janë në proces zbatimi **2**, si dhe **2** rekomandime të pa realizuara.

b. Për shpërblim dëmi janë lënë **1** rekomandime për shumën **61,215** mijë lekë, e cila është arkëtuar plotësisht.

Në përfundim rikërkojmë nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Pyjeve Shkodër përshpejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandim 16: Kryeinspektori i DR ISHMP Shkodër, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe të Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për instalimin dhe vendosjen e sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të hartohen e miratohen rregullat për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të Ligjit.

Rekomandim 17: Nga ana e DR ISHMP Shkodër të merren masat që Sektori i Shërbimeve të Brendshme, (zyra teknike) të fillojë menjëherë procedurat përkatëse të regjistrimit të pasurisë në ZVRPP Shkodër.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rikërkojmë Ministrin të Turizmit dhe Mjedisit Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë**, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

C.1. “Vërejtje” deri në **“Largim nga Shërbimi civil”**, për 7 punonjës si më poshtë:

1. Për z. E. B, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Mjedisit,
2. Për z. N. D, me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit,
3. Për z. Sh. Ç, me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit,
4. Për z. V. G, me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit,
5. Për z. N. P, me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit,
6. Për z. N.H, me detyrë inspektor në Sektorin e Mjedisit,
7. Për z. A. L, me detyrë specialist i financës,

C-2. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b”, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rikërkojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë**, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

C-3. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rikërkojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Mjedisit dhe Pyjeve Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, për 8 punonjës si më poshtë:

1. Për z. V. Z, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
2. Për z. A. B, me detyrë përgjegjës i sektorit të inspektimit pyjore,
3. Për z. D. E, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
4. Për z. Q.B, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
5. Për z. P. V, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
6. Për z. P. L, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
7. Për z. F. M, me detyrë inspektor i policisë pyjore,
8. Për z. E.E, me detyrë inspektor.

6. NË DREJTORINE RAJONALE TË MJEDIST DHE PYJEVE, ELBASAN.

Nga auditimi i ushtruar në DR ISHMP Elbasan, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 30.09.2015 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr.177, datë 29.16.2016 të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 702/25, datë 11.04.2016, konstatohet se:

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në DR ISHMP Elbasan, nuk ka kthyer përgjigje KLSH, brenda afatit 20 ditor nga dërgimi i rekomandimeve si dhe nuk është hartuar plani i veprimit me afate konkrete dhe persona përgjegjës për realizimin e rekomandimeve.

në DR ISHMP Elbasan, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda 6 muajve nga përcjellja e rekomandimeve të KLSH. Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 43 rekomandime gjithsej, nga këto: 20 masa organizative dhe 3 masë të ardhura të munguara me vlerën 43 200 mijë lekë si dhe 19 masa disiplinore, nga të cilat 9 masa “Vërejtje me paralajmërim” dhe 10 masa për “Zgjidhje të kontratës së punës”.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a.Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 43 masa organizative, të cilat, janë pranuar plotësisht 43, janë zbatuar 15 rekomandime dhe janë në proces zbatimi 2 rekomandime të pa zbatuara 3.

b.Për shpërbllim dëmi janë lënë 4 rekomandime për shumën 5,868,510 lekë të arkëtueshëm, të cilat, janë pranuar, dhe janë në proces zbatimi 4 rekomandime në vlerën 4,549,010 lekë dhe arkëtuar 1,319,500 lekë.

c.Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” dhe në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës janë rekomanduar:9 masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” dhe 10 masa “Zgjidhja e kontratës individuale”, nga cilat nuk janë zbatuar asnjë masë e dhënë.

Në përfundim rikërkojmë nga DR ISHMP-së Elbasan, përshejtimin e procesit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, që kanë rezultuar të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht.

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 6: DR ISHMP Elbasan të marrë masa, për të programuar kontrole të vazhdueshme dhe të hartojë plane konkrete, duke i dhënë përparësi inspektimit në fushën e mjedisit, në zonat turistike, zonat e mbrojtura që ndodhen në Qarkun e Elbasan, për të ndikuar pozitivisht në rritjen e cilësisë mjedisor.

Rekomandimi 15:DR ISHMP Elbasan të marrë masa, të hartojë, miratojë dhe ndjekë zbatimin e dokumentit të Strategjisë dhe Planin strategjik, në zbatim të procedurave përkatëse, duke përcaktuar qartë tregues të matshëm, krahasueshëm, etj.

Rekomandimi 16: Titullari i institucionit të hartojë dhe të miratojë rregullat përgjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave në zbatim të ligjit.

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA

Rekomandimi1: DR ISHMP Elbasan të marrë masa për të sjell, të dhënat e vet monitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë, planin e menaxhimit të mbetjeve, raportimin e të dhënave të vet monitorimeve në institucionet përgjegjëse ARM, AKM dhe ISHMP Elbasan për të monitoruar dhe programuar kontrole më të shpeshta të subjekteve. Në çdo rast të konstatimit të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore, të zbatohet masa administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtës.

Rekomandimi 2: DR ISHMP Elbasan të marrë masa, për të monitoruar dhe programuar kontrole më të shpeshta të subjekteve, që përmbajnë risk më të lartë lidhur me shkeljet në fushën e mjedisit. Të rikontrollohen të gjithë subjektet që janë klasifikuar me shkelje të dispozitave ligjore, duke përcaktuar nëse është bërë korrigjimi i parregullsive të konstatuara, në çdo rast të konstatimit të mos përmbushjes së detyrimeve ligjore, të zbatohet masa administrative dënim me gjobë për subjektet kundërvajtës, konforme përcaktimeve ligjore .

D. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rikërkojmë Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe Kryeinspektorit të ISHMP-së Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status të nëpunësit civil, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për:

C/2 . Nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga shërbimi civil*”, për punonjësit e mëposhtëm:

- **Për z. S. Sh**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit ,
- **Për z. E. B**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit,
- **Për z. A. Zh**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit,
- **Për z. Y. K**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit,
- **Për z. F. S**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit,
- **Për z. B. M**, me detyre innspektor në sektorin e Mjedisit.

C/3. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011“Për Mbrojtjen e Mjedisit”**i rikërkojmë Kryeinspektorit ISHMP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe të marr masa disiplinore nga“*Vërejtje me paralajmërim*” për punonjësit e mëposhtëm :

- **Për z. Xh. Xh**, me detyrë ish/Përgjegjës i sektori të pyjeve Librazhd,
- Inspektorë në sektorin e Policisë Pyjore,
- Për z. K. Q**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- Për z. B. H**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. A. H**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. Y.K**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. M. Gj**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. L. S**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. B. C**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. S. B**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve,
- **Për z. G. S**, me detyre innspektor në sektorin e Pyjeve.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R